

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ-** Departamenti i Pergjithshem- Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtesen Minrie Krasniqi, ne ceshtjen e inicuar me padine e paditesit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED] të cilin e përfaqëson avokati [REDACTED] nga [REDACTED] kunder te paditurit [REDACTED] ([REDACTED]) me pare nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED], tani me adrese te panjohur te cilin e perfaqeson perfaqesuesi i perkohshem av. [REDACTED] nga [REDACTED] per vertetim pronesie, ne séance e mbajtur me date 04.10.2016 merr kete:

**A K T G J Y K I M**  
- ne baze te pohimit -

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED], dhe **VËRTETOHET** se paditësi është pronar i paluajtshmerise me numër të njësisë kadastrale **P-72217068-00315-2**, vendi i quajtur "Dubrave", me sipër.1193m<sup>2</sup>, ne zonen kadastrale Pleshine- Ferizaj, sipas skcies gjeodezike te gjeodetes [REDACTED]

**OBLIGOHET** i padituri [REDACTED] ([REDACTED]) që paditësit t'ia njohin te drejtën e pronësisë mbi kete prone dhe te lejon regjistrimin e saj ne regjistrat kadastral në emër të paditësit, ketë në afat prej 15 ditësh pas pranimit te kopjes së tij, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërben paditësit ai autorizim për të bërë regjistrimin e pronës në emër të tij.

**OBLIGOHET** paditësi që të bëjë pagesën e shpenzimeve për përfaqësim nga përfaqësuesi e perkohshëm i të paditurit ne shume prej 405€, shpenzimet e ekspertit te gjeodezise 100€ si dhe taksën për padi ne shume prej 35€ dhe aktgjykim ne shume prej 50€, ne afat prej 15 ditesh pas pranimit te ketij aktgjykimi.

**A r s y e t i m i**

Paditesi ka pretenduar me padi se gjatë viteve të '60-ta, pasi qe ai ka qene i mitur ne ate kohe vetem 17 vjeqe, dhenderri i tij [REDACTED], ne baze te marrveshjes gojore me te padituren, kane bere shitblerjen e prones objekt kontesit, me numer te njesis kadastrale 00315-0, me sipër.6303m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale Pleshine, dhe se te njejten prone e kane ndare ne pjese te ndryshme secili (paditesi, dhenderri i tij dhe disa kusherinje te tjere). Po ashtu paditesi ka pretenduar se ka permbushur ne teresi detyrimet lidhur me pagesen e cmimit dhe ka marr ne posedim te papenguar pronen nga i padituri nga vitet e '60-ta e tutje si dhe ka kerkuar t'i njihet e drejta e pronesise mbi bazen e shitblerjese dhe të posedimit me mirebesim.

Gjykata, fillimsht, ka aprovuar propozimin e paditësit që të paditurit t'i caktohet perfaqesuesi i perkohshem, meqenese i njejti është shpërngulur jashte Kosoves dhe nuk ka e as qe mund te sigurojne ndonje informacion, per vendndodhjen e tij.

Gjykata aktvendimin per caktimin e perfaqesuesit te perkohshem e ka publikuar ne gazeten zyrtare te Republikes se Kosoves dhe ne tabelen e shpalljeve te kesaj gjykate.

A.C.M.E.  
Udh. Or.

Paditësi përmesë të autozuarit të tij, në fjalën përfundimtare ka theksuar se nga provat e administruara, e veçanarisht nga provat materiale siç janë aktgjykimi ne baze te pranimit dhe padia qe e paditura ka inicuar ne ate kohe kunder te paditurit [REDAKTUAR] (dhëndërrri i paditësit), nga kjo rrethan u vertetuar qe prona e të paditurit i është shitur [REDAKTUAR] (dhëndërrri i paditësit), i cili në atë kohë kishte blerë këtë pronë, pasi që paditësi ishte i mitur vetëm 17 vjeç, si dhe gjendja është vërtetuar edhe në terren, ku rezulton se paditësi është në shfrytëzim me mirëbesim që nga viti 1962 i sipërfaqes prej 1193m<sup>2</sup> në zonën kadastrale Pleshinë.

Perfaqesuesi i perkohshem av. [REDAKTUAR] në seancat e shqyrtimit pergatitor ka kontestuar kërkesë padin e paditësit, mirëpo gjatë seancës së shqyrtimit kryesor dhe në fjalën e tij përfundimtare nuk ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit që paditësi të shpallet pronar i pronës kontestuese, si dhe ka deklaruar se gjendja faktike është në harmoni me gjendjen e provave nga të cilat është vërtetuar i gjithë pretendimi i paditësit, andaj ka theksuar që janë krijuar rrethanat që në këtë çështje të vendoset në mënyr mërtiore në pajtim me gjendjen faktike të vërtetuar dhe nga provat materiale të administruara. I ka kërkaru shpenzimet e procedures per perfaqesim te perkohshem.

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të pohuar duke qenë se në mes palëve ndërgjyqjësë nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se perfaqesuesi i te paditurit shprehimisht ka pranuar kerkespadine dhe në anën tjetër, gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes nuk ka gjetur ndonjë rrethanë, për të cilën duhet kujdesur kryesisht e cila do te pengonte aprovimin e kërkesëpadisë dhe rrethana tjera që t'i vënte në kundërshtim faktet dhe provat e çështjes me pohimin e kërkesëpadisë nga ana e përfaqësuesit të perkohshëm të të paditurit, ndaj ne kuptim te nenit 148 të LPK-së, ka nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit.

Gjykata me qëllim te vertetimi te rrethanave lidhur me poziten dhe shtrirjen e pronës kontestuese ka bere identifikimin e saj permes ekspertit te gjeodezise, gjeodetes [REDAKTUAR] me ane te te cilit ka percaktuar paramasat dhe kufizimet e pronës objekt kontesti, nga ku ka sqaruar sipërfaqen e pronës si dhe sipërfaqen e pjesës së pronësisë të paditësit, pozicionimin e saj- shtrirjen kadastrale ne zone, pronarin juridik te saj dhe shfrytezuesit aktual te saj dhe per keto te gjetura te ekspertizes gjykata i ka pranuar ne teresi si professional dhe ne perputhje me gjendjen faktike dhe zyrtare.

Gjykata përveqë që ka pranuar në tërësi ekspertizen gjeodezike ka bërë edhe administrimin e provave të tjera si vijon; Aktgjykimi numer C.nr.1021/62, Padia e [REDAKTUAR] kunder të paditur [REDAKTUAR] e dorëzuar me datën 27.07.1962, dëgjimin e dëshmitarëve [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna [REDAKTUAR].

Shpenzimet e procedures per perfaqesim te paditurit nga perfaqesuesi i perkohshem në shumë prej 405€ gjykata ia ka ngarkuar paditesit ne kuptim te nenit 81 par.2 lidhur me nenin 453 te LPK-se, për shpenzimet e ekspertit të gjeodezisë në shumë prej 100€ në kuptim të nentit 451 të LPK-së, ndersa taksën për padi në shumë prej 35€ dhe për aktgjykim ne shume prej 50€, ne baze te nenit 445 te LPK-se.

Andaj, mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme dhe në kuptim të nenit 148 të LPK-së, është vendosur si ne dispozitiv të ketij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**  
**C.nr.262/09, me datën 04.10.2016**



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kunder ketij aktgjykimi mund të ushtrohet ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kesaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA

